

**VENDIM****Nr. 45, datë 19.9.2016**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT  
PËR PROJEKTE, THIRRJA III, E  
GRANTIT “INFRASTRUKTURA  
VENDORE DHE RAJONALE”,  
PROGRAMI “ZHVILLIMI I  
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE  
RAJONALE”, SHTYLLA I, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve


**VENDOSI:**

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja III, për vitin 2016, për grantin “Infrastruktura  
Faqe | 20582

vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatin teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, përpara fundit të tremujorit të katërt, të vitit 2016.



**Shënim:**

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të projektit (kur ka/nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Kjo vlerë shërben si referencë për përlogaritjen e vlerës së financimit për vitin 2016 dhe, “korrektohet” nga vlera e kontratës (pas prokurimit), pas nënshkrimit të saj. Fondi i përftuar nga diferenca ndërmjet vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, i shtohet portofolit të grantit të infrastrukturës vendore e rajonale, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe rishpërndahet për financimin e projekteve të reja dhe/ose projekteve në vazhdim.
2. “Vlera e bashkëfinancimit” përfaqëson vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga Bashkia Tiranë, si angazhim financiar për financimin e vlerës së plotë, të këtij projekti.
3. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.
4. “Vlera e financimit për vitin 2017” tregon diferencën e financimit të vlerës së kontratës me vlerën e financimit për vitin 2016.
5. Për projektet e financuara më sipër, në tabelën 1, të cilat gjejnë zbatim në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”.
6. Për projektet e financuara më sipër, në tabelën 1, të cilat gjejnë zbatim pranë strukturave ujore dhe/ose lumenjve dhe/ose përrrenjve, autoritetet kontraktuese duhet të konsultohen për zbatimin e projektit me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.